



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

Nr.1210 _date 23.07.2001

Nr.2037 Date 23.07.2001

UDHËZIM

PËR MBAJTJEN E PROCESVERBALEVE TE KALLËZIMIT PERSONAVE TE KEQTRAJTUAR JASHTË SHTETIT,

Nisur nga konstatimet e ngritura, ne shkresën nr. sh-4/3, date 3.07.2001, nga Avokati i Popullit për keqtrajtimin e shtetasve shqiptar nga policitë e shteteve fqinje, te cilët për arsye te ndryshme, kane qene jashtë dhe kthehen ne mënyre te dhunshme, me qellim qe te evidentohen këto raste dhe te ndiqen procedurat ligjore, ne mbështetje me neni 102, pika 4 te Kushtetutës, Ligjit Nr . 8553, date 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", neni 7, pika 2 dhe ne zbatim te Ligjit nr. 8773, date 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë" dhe nenit 283 te K.Pr.Penale,

UDHËZIJMË

1. Oficeret e Policisë Gjyqësore ne pikat e kontrollit te kalimit kufitar, për rastet e keqtrajttimeve te shtetasve shqiptar ne territoret e shteteve te huaja, te mbajnë procesverbal kallëzimi te krimit te kryer.
2. Procesverbali i kallëzimit te mbahet ne mënyre te hollësishme me te gjitha gjeneralitetet dhe vendbanimin e plote te kallëzuesit
3. Për rastet kur është e mundshme procesverbali i kallëzimit te shoqërohet me prova materiale apo gjithçka tjetër, qe vërteton shpjegimet e tyre për përdorimin e dhunës.

4. Procesverbalet e kallëzimit se bashku me provat materiale te dërgohen ne Prokurorinë e Rrethit, ku është konstatuar keqtrajtimi.
5. Për te gjitha rastet e keqtrajtimit te shtetasve shqiptar jashtë shtetit te informohet Drejtoria e Policisë Kufitare pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Policisë se Shtetit ne Ministrinë e Rendit Publik.
6. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë se Shtetit

